

RADIO  
TELEVIZIONI  
SHQIPTAR

**KËSHILLI DREJTUES I RTSH**  
**NR 290 PROT**

Tiranë më 06.03.2020

**VENDIM**  
**NR. 8, date 06.03.2020**

Në zbatim të nenit 102 pika 10 të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 "Për median audiovizive ne RSH", nenit 17 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr 98, datë 22.12.2016 "Për miratimin e Statutit të RTSH", dhe nenit 15 të kontratës së shërbimit të transmetimit publik midis RTSH dhe AMA pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH me shkresën nr 501 prot, date 14.02.2020, mbi shqyrtimin dhe miratimin e shtesës së kontratës së shërbimit të transmetuesit public mes RTSH dhe AMA, për çeljen e një program të ri radio, Radio Tirana Jazz, Këshilli Drejtues i RTSH në mbledhjen e tij datë 06.03.2020 me votimin pro të 8 anëtarëve të pranishëm K.Traja, Xh.Aliu, Xh.Mato H.Haliti, P. Përvathi, S. Kumbaro, A.Peqini dhe V.Grosha;


**VENDOSI:**

I. Të miratojë shtesën e kontratës së shërbimit të transmetuesit publik mes RTSH dhe AMA për çeljen e një program të ri radio, Radio Tirana Jazz. (Sipas shtesës së kontratës së shërbimit të transmetuesit publik mes RTSH dhe AMA bashkëngjitur vendimit)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KESHILLIT DREJTUES TE RTSH**

**Kristaq TRAJA**



## SHTOJCË KONTRATË E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT PUBLIK

E lidhur sot më, datë \_\_\_/\_\_\_/2020, me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar, midis palëve:

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**, me seli në Tiranë, rruga “Abdi Toptani”, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Gentian SALA, që më poshtë do t’i referohemi si **AMA**.

dhe

**RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR**, me seli në Tiranë, rruga “Ismail Qemali”, Nr.11, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, Z. Thoma GËLLÇI, që më poshtë do t’i referohemi si **RTSH**.

### Duke patur parasysh se:

- RTSH dhe AMA kanë nënshkruar kontratën e shërbimit të transmetimit publik në zbatim të nenit 117 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
- RTSH kërkon të shtojë një shërbim të ri për publikun, duke çelur një program të ri audio (radio), që do t’i kushtohet vetëm muzikës jazz dhe që do të transmetohet nëpërmjet rrjetit tokësor të shpërndarjes DVB-T2 të RTSH-së dhe nëpërmjet internetit, në aplikacionin RTSH Tani.
- Neni 15 i kontratës së shërbimit të transmetimit publik ka parashikuar të drejtën e RTSH-së për të bërë shtesë në shërbimet që ofron për publikun, si në çeljen e kanaleve të reja, ashtu edhe në shtimin e transmetimeve të reja lokale apo rajonale.
- Këshilli Drejtues i RTSH-së i ka pranuar paraprakisht këto ndryshime, duke miratuar çeljen e këtij shërbimi të ri për publikun me vendimin nr. \_\_, datë \_\_. \_\_. 2020.

Në këto kushte, me anë të kësaj shtojce-kontrate, RTSH dhe AMA bien dakord me vullnetin e tyre të lirë që të bëjnë shtesat si më poshtë në kontratën e nënshkruar mes tyre.

### Neni 1 Objekti

Në nenin 6 të kontratës së shërbimit të transmetimit publik shtohet paragrafi si më poshtë:

Shërbimi i ofruar nga Radio Tirana Jazz për publikun shqiptar konsiston në transmetimin e programeve me muzikë jazz, i cili do të jetë një program me kohëzgjatje 24 orë në 24, që do të përcillet në zonën e mbulimit, sipas të dhënave teknike për rrjetin e transmetimit tokësor DVB-T2 të RTSH-së dhe në internet nëpërmjet aplikacionit RTSH Tani. Programet radiofonike që do të transmetohen nëpërmjet "Radio Tirana Jazz" do të jenë të natyrës muzikore jazz dhe do të përmbajnë repertorin më të mirë të muzikës jazz në botë.

## **Neni 2 Rrjeti i transmetimit**

Ky do të jetë një shërbim transmetimi kombëtar pa pagesë për publikun dhe i kapshëm për sa është e mundur nga të gjithë shtetasit në Republikën e Shqipërisë dhe shqiptarët jashtë Republikës së Shqipërisë. Transmetimet e Radio Tirana Jazz do të bëhen vetëm nëpërmjet rrjetit të transmetimeve tokësore DVB-T2 të RTSH-së dhe në internet nëpërmjet shërbimit OTT në aplikacionin RTSH Tani.

## **Neni 3 Afati**

Kjo shtojcë kontrate do të ketë të njëjtin afat kohor si edhe kontrata e shërbimit të transmetimit publik RTSH - AMA.

## **Neni 4 Dispozitat e fundit**

Kjo shtojcë kontrate ndryshon vetëm pikat e përcaktuara më lart, ndërsa të gjitha përcaktimet e tjera mbeten të pandryshueshme nga kontrata e nënshkruar mes palëve. Kjo shtojcë kontrate nënshkruhet në dy kopje nga një kopje për secilin palë, në gjuhën shqipe në 4 nene.

## **Palët**

**Për RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR  
Drejtori i Përgjithshëm**

**Thoma GËLLÇI**

**Për AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
Kryetari**

**Gentian SALA**